



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË**  
**PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

**NJOFTIM PËR MEDIAT**

**1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** me datë **28.01.2026** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 73/2024, në ngarkim të të pandehurve: **Kledian Llaho, Vasil Bakalli, Pando Papuçi** dhe **Çlirim Shahini**.”.

**2.** Në seancën e datës **06.05.2026** (seanca paraprake), Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Engjëllushe Tahiri, pasi shqyrtoi pretendimet e palëve, me vendimin nr. **69**, datë **06.05.2026**, bazuar në nenet 332 e vijues të K.Pr.Penale, vendosi:

- Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
- Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 73/2024 në ngarkim të të pandehurve:
  - Kledian Llaho** për veprat penale “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit, apo funksionarëve të tjerë të sistemit të drejtësisë*” në bashkëpunim dhe “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj funksionarëve publikë*”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319/ç – 25, 245/1 paragrafi i katërt, dhe 25 të Kodit Penal;
  - Vasil Bakalli**, për veprat penale “*Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit, apo funksionarëve të tjerë të sistemit të drejtësisë*” në bashkëpunim dhe “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj funksionarëve publikë*”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319/ç - 25, 245/1 paragrafi i katërt, dhe 25 të Kodit Penal;
  - Pando Papuçi**, për veprën penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj funksionarëve publikë*” parashikuar nga neni 245/1, paragrafi i dytë i Kodit Penal në 2 episode;
  - Çlirim Shahini**, për veprën penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj funksionarëve publikë*”, parashikuar nga neni 245/1, paragrafi i katërt i Kodit Penal,

trupit gjykues të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të përbërë nga 3 (tre) gjyqtarë.

- Së bashku me kërkesën e Prokurorisë për dërgimin e çështjes për gjykim, dërgohet dhe kërkesa e të pandehurit Pando Papuçi për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të tij sipas procedurës së parashikuar për gjykimin e shkurtuar.

4. Fashikulli i gjykimit përmban të gjitha provat e Prokurorisë së Posaçme sipas akteve të hetimit; provat shkresore të depozituara gjatë seancës paraprake nga të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre; kërkesa me shkrim për gjykim të shkurtuar e të pandehurit Pando Papuçi.
5. Ngarkohet Kryesekretaria e Gjykatës të vijojë procedurat për hedhjen në short të çështjes me qëllim formimin e një trupi tjetër gjykues.
6. Ngarkohet sekretaria gjyqësore të dorëzojë vendimin për dërgimin e çështjes në gjyq dhe fashikullin e gjykimit brenda 10 (*dhjetë*) ditëve pranë Kryesekretarisë.
7. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

**Tiranë, më datë 07.05.2026**

**Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**